



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.4 Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/2018 dhe nenit 7 të Rregullores për punën e Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”, nr. 01-640/01-0051835/21 në kërkesë të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr. prot.02-114/02-0088033/21, datë 05.10.2021, Kryetari i Komunës së Podujevës, nxjerr këtë :

V E N D I M

Neni 1

Lejohen mjetet financiare në shumë nga 50 € anëtarëve të Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit “Avdush Hasani” në Komunën e Podujevës, si formë e kompensimit për takimin e mbajtur më 23.09.2021.

Neni 2

Kompensimi sipas nenit 1 të bëhet duke respektuar rregullativën ligjore përkatëse në fuqi, ndërsa bartja e mjeteve bëhet përmes llogarive bankare të anëtarëve të Këshillit sipas dokumentacionit bashkëngjitur këtij Vendimi, të procedur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Nr. prot. 02-400/03-0088253/21
Podujevë, dt. 05 tetor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354 të datës 12 janar 2021, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere merr:

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE

Neni 1

Gjashtëdhjetë e pesë (65) personave në gjendje të rëndë sociale-ekonomike dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare, në shumë të përgjithshme 7,550.00€, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0089049/21
Podujevë, 07 tetor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNES

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenet 16 dhe 61 nën paragrafi 1.1, të statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, nenin 10 parag.1 shkronja d) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354/21, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas kërkesës nr.09-615/03-0076764/21 të datës 06.09.2021, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

znj.Rifadie Bllaca nga Podujeva me vendbanim rr.”Ali Ajeti”, për organizimin e projektit “PoDuArtColony”, që ka për qëllim promovimin e artistëve vendas dhe ndërkombëtar, të vlerave artistike që bartin, si dhe këmbimin e përvojave mes veti, aktivitetet që do të zgjasë 5 ditë në Komunën e Podujevës, mbështetet me mjete financiare në shumë 500€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e znj.Rifadie Bllaca.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/03-0087062 /21
Podujevë, 01 tetor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.09-615/03-0080532/21 të datës 14.09.2021 të OJQ-Aeroklubi Llapi, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ - AEROKLUBI LLAPI

Neni 1

OJQ-Aeroklubi Llapi, për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare dhe kombëtare (*Suhareka Open 2021, Prilep Maqedoni e Veriut kampionati i 11 botëror në pozicion dhe Oludeniz të Turqisë*), mbështetet me mjete financiare, në shumë 500.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ Aeroklubi Llapi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0089057/21
Podujevë, 07 Tetor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bëlliçi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.09-615/03-0088525/21 të datës 05.10.2021 të OJQ- Qendra Sportive Rekreative “Kroni”, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ - QENDRA SPORTIVE REKREATIVE “KRONI”

Neni 1

OJQ- Qendra Sportive Rekreative “Kroni”, për pjesëmarrje në kampionatin e Kosovës “Kosova Grappling Championship 1”, mbështetet me mjete financiare, në shumë 500.00€.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ Qendra Sportive Rekreative “Kroni”.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0089059/21
Podujevë, 07 Tetor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.09-615/03-0085299/21 të datës 27.09.2021 të OJQ-Klubi i Gjimnastikës “Llapi”, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ - KLUBI I GJIMNASTIKËS “LLAPI”

Neni 1

OJQ- Klubi i Gjimnastikës “Llapi”, për mbështetje në plotësimin e kushteve (pajisje me vegla sportive) për zhvillimin e aktiviteteve sportive, mbështetet me mjete financiare, në shumë 500.00€.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ Klubi i Gjimnastikës “Llapi”.


Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0089061/21
Podujevë, 07 Tetor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.04-400/04-0084020/21 të datës 23.09.2021 të OJQ- You Can Do , Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ - YOU CAN DO

Neni 1

Organizata Jo Qeveritare e të verbërve “You Can Do”, për zhvillimin e aktiviteteve me rastin e 15 tetorit, Ditës Ndërkombëtare të “Shkopit të Bardh”, mbështetet me mjete financiare, në shumë 300.00€.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ- You Can Do.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0090781/21
Podujevë, 12 Tetor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 8 dhe 13, të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354 të datës 12 janar 2021, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere dhe në kërkesë nr.prot 06-550/01-0092750/21, të datës 20.10.2021 Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M **PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE**

Neni 1

znj.Jehona Havolli, me vendbanim në fshatin Llapashticë e Epërme, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore (për trajtim urgjent shëndetësor), i jepet ndihmë financiare në shumë 2,000.00€,

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve n'kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/04-0093164/21
Podujevë, 20 tetor 2021



Kryetari i Komunës
Shefqet Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 14 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore 2022-2023 nr.01-400/03-0059131/20, dt. 30.09.2020, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0002354/21, dt. 12 janar 2021 për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, në kërkesë nr. 05-016/03-0091712/21 datë 14.11.2021, të proceduar nga Drejtoria e Arsimit përmes shkresës nr. 05/ 612 datë 19.10.2021, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE

Neni 1

znj.Nexhmie Rrmoku, nga fshati Herticë, Komuna e Podujevës, për mbulimin e shpenzimeve të transportit shtëpi-shkollë dhe anasjelltas të vajzës së saj Rina Rrmoku, e cila është me nevoja të veçanta (e palëvizshme në ekstremitet e poshtme), për vijimin e vitit shkollorë 2021-2022 në SHFMU “Naim Frashëri” Podujevë, i jepet ndihma financiare në shumë 500 €.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve dhe përmes bankës barten në llogarinë e znj. Nexhmie Rrmoku.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e arsimit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/03-0093093/21
Podujevë, 20 tetor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 17 shkronja i) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 16 dhe 19 paragrafi 1.9 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në kërkesë me nr.04-400/04-0090379/21 të datës 12.10.2021 të Njesisë për të Drejtat e Njeriut - NJDNJ në Komunën e Podujevës, nxjerrë,

V E N D I M

Neni 1

Me rastin e hapjes së fushatës njëmuajore “Tetori – Muaji i mundësive të barabarta për personat me nevoja të veçanta”, n’kuadër të fushatës kundër diskriminimit, lejohen mjete financiare në shumë 200.00€.

Neni 2

Mjetet sipas nenit 1, dedikohen për kompensimin e 10 persona me nevoja të veçanta, nga 20.00€ për secilin, për angazhimin një (1) ditor në administratën komunale, të cilët caktohen nga NJDNJ në koordinim me OJQ Handikos – Podujevë.

Neni 3

Mjetet financiare ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere dhe të njëjtat barten në llogarinë bankare të OJQ Handikos e cila obligohet që mjetet e cekura t’ua shpërndaj personave të caktuar, dhe të paraqesë raport si dëshmi për shpërndarjen e mjeteve.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në koordinim me NJDNJ dhe OJQ-në – Handikos, që obligohen të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e këtij aktivitetit dhe ekzekutimin e kompensimit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave
Njësitit për të Drejtat e Njeriut
OJQ-së “Handikos”

Nr.02-400/03-0093260/21
Podujevë,
21 tetor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në kërkesë të përfaqësueses së projektit “ Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2” (ReLOaD2) datë 14 tetor 2021, merr:

V E N D I M

Neni 1

Formohet Grupi përfaqësues i Komunës së Podujevës për zbatimin e projektit “ Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2” (ReLOaD2), në këtë përbërje:

1. Memli Gashi, koordinator- Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik
2. Ejup Babatinca, zv. Koordinator- Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik
3. Ardonis Jusufi, anëtar- Drejtorja e Buxhetit dhe Financave
4. Liridona Rrahmani, anëtare – Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim

Neni 2

Grupi i përcaktuar sipas nenit 1, për fushat referente në kuadër të projektit ReLOaD2 do të bashkëpunojë me Ekipin përkatës në funksion të zbatimit të aktiviteteve që rrjedhin nga projekti në fjalë, si dhe do të ndjek trajnimet e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve në ciklin e menaxhimit të projektit (CMP) dhe në fusha tjera me rëndësi të parapara me rregullativën ligjore në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

U dërgohet:
Anëtarëve të Grupit
Menaxheres së projektit
Arkivës

Nr.prot. 02-020/04-0094031/21
Podujevë, 25 tetor 2021

